



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/65
Datë: 08.03.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës

Neni 1
Themelimi dhe Qëllimi

1. Themelohet Akademia Diplomatike e Kosovës (tutje Akademia) si institucion publik me qëllim të përgatitjes dhe formimit profesional të anëtarëve të personelit në Shërbimin e Jashtëm për nevojat e Ministrisë së Punëve të Jashtme.
 - 1.1. Akademia do të veprojë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe do të ketë të drejtën për të pasur të hyra, duke u bazuar në pajtim me ligjin në fuqi.
 - 1.2. Akademia gëzon të drejtën për të pasur të hyrat që konsistojnë në donacione, publikime dhe kontrata të ndryshme të këshillimeve dhe ndihmë të jashtme, në pajtim me ligjin.
 - 1.3. Akademia për funksionalitetin e sajë bashkëpunon me institucione tjera brenda dhe jashtë Kosovës, në pajtim me ligjin

Neni 2 **Veprimtaria e Akademisë**

1. Duke njohur specifikat e Politikës së Jashtme të Republikës së Kosovës në kontekstin e shtet-ndërtimit dhe konsolidimit të subjektivitetit të saj ndërkombëtarë, si dhe duke njohur mungesën e këtij institucioni, Akademia do të kryej punët profesionale me karakter edukues, trajnues, hulumtues dhe këshillues në sferën e Politikës së Jashtme dhe Diplomacisë, që kanë të bëjnë me:
 - 1.1. Organizimin dhe udhëheqjen e trajnimeve të stafit diplomatik dhe konsullor;
 - 1.2. Ndërmarrjen e aktiviteteve hulumtuese si dhe publikimin e revistave dhe recensioneve periodike dhe studime lidhur me fushat e lartpërmendura;
 - 1.3. Organizimin e konferencave dhe seminareve në fushën e politikës ndërkombëtare dhe diplomacisë publike, si dhe zhvillimin e bibliotekës së Akademisë;
 - 1.4. Mbështetjen e kërkesave të drejtorive tematike dhe gjeografike të Ministrisë, si dhe Shërbimit të Jashtëm të definuar në bazë të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
 - 1.5. Konceptimin e projekteve të përbashkëta speciale me Ministrinë e Punëve të Jashtme;
 - 1.6. Lidhjet e bashkëpunimit me institucionet homologe me karakter ndërkombëtarë;
 - 1.7. Kryen punët tjera profesionale me karakter strategjik që ia beson Ministri i Punëve të Jashtme.

Neni 3 **Udhëheqja me Akademinë**

1. Me Akademinë udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë, i cili emërohet me mandat të caktuar nga Ministri i Punëve të Jashtme në pajtim me nenin 4. të këtij vendimi.
 - 1.1. Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë për punën e tij mban përgjegjësi direkte ndaj Ministrit të Punëve të Jashtme, është përgjegjës për menaxhimin e gjithëmbarshtëm të Akademisë dhe për sigurimin e zbatimit të autorizime që i janë bartë Akademisë, si dhe menaxhimin efikas dhe efektiv të resurseve të Akademisë;

- 1.2. Ministri emëron Bordin Akademik si dhe udhëheq me të, si organ vendimmarrës që ofron orientimet programore dhe strategjike të Akademisë si dhe kontribuon në ngritjen e cilësisë profesionale të Akademisë;
- 1.3. Anëtarët e Bordit Akademik emërohen me mandat të caktuar nga Ministri e Punëve të Jashtme dhe përbëhen nga ekspertë, specialist nga fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave politike, ambasadorë të karrierës dhe përfaqësues të shoqërisë civile;
- 1.4. Bordi Akademik miraton programin e trajnimeve bazuar në nenin 2. të këtij vendimi dhe shërben si platformë e diskutimeve brenda Akademisë;
- 1.5. Bordi Akademik në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm ka të drejtë të emëroj Anëtarët e Nderit, në shërbim të përkrahjes dhe avancimit të veprimtarisë institucionale të Akademisë;
- 1.6. Përveç Drejtorit të Përgjithshëm, anëtarët e Bordit Akademik mund të përfaqësojnë Akademinë në aktivitetet jashtë vendit;
- 1.7. Me qëllim të realizimit më efikas të veprimtarisë trajnuese, hulumtuese dhe këshilluese dhe të aktiviteteve tjera të cilat përcjellin këtë fushë, në Akademi veprojnë këto njësi organizative:
 - 1.7.1. Divizioni për trajnime dhe zhvillim të Shërbimit të Jashtëm dhe
 - 1.7.2. Divizioni për studime, hulumtime dhe publikime.
- 1.8. Për qëllime të ngritjes së kapaciteteve të trajnimit dhe hulumtimit, Akademia mund të angazhoj edhe Bashkëpunëtor të Jashtëm në baza periodike.

Neni 4

Funksionalizimi i Akademisë Diplomatike

Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, që në pajtim me paragrafin 2. të nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës të rregulloj funksionalizimin e Akademisë Diplomatike.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe do të aplikohet nga viti 2013.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë